

Reforma e mbrojtjes dhe gjinia

PËRMBAJTJA:

Pse është gjinia e rëndësishme për reformën e mbrojtjes?

Si mundet gjinia të integrohet në reformën e mbrojtjes?

Sfidat dhe mundësitë e pas-konfliktit.

Pyetje për reformën e mbrojtjes

Më shumë informata

Ekziston një përkrahje e fuqishme e konceptit që reforma e sigurisë duhet ti përmbushë nevojat e posaçme të burrave, grave, djemve dhe vajzave. Integrimi i çështjeve gjinore është gjithashtu çelësi për efektivitetin dhe përgjegjshmerinë e sektorit të sigurisë si dhe të pronës lokale dhe legjimitetit të RSS.

Ky Shënim Praktik jep një hyrje të shkurtër për përfitimet e integritit të çështjeve gjinore në reformën e mbrojtjes, si dhe informacion praktik për të bërë këte.

Ky Shënim praktik është i bazuar në një udhëzues (TOOLKIT) më të gjatë, dhe të dyjat janë pjesë e kapitullit GJINIA dhe RSS. Është dizajnuar për të siguruar një hyrje për çështjet gjinore për praktikuesit e RSS dhe politikë-bërësit. Kapitulli përfshin 12 vegla me Shënime Praktike përkatëse - shih në pjesën Më shumë informata.

Pse është gjinia e rëndësishme për reformën e mbrojtjes?

Reforma e mbrojtjes përfshin transformimin e sektorit të mbrojtjes së një shteti të caktuar në mënyrë që institucionet: të jenë nën kontrollin civil; të respektojnë parimet e përgjegjshësisë dhe qeverisjes së mirë, të mbajnë fuqi të përshtatshme në numër, të kenë përbërje reprezentative; të jenë të trajnuar në mënyrë adekuate dhe të pajisur në mjedisin e tyre strategjik dhe të veprojnë konform ligjeve ndërkombëtare, dhe kështu të kontribuojnë në synimet kombëtare dhe ndërkombëtare të paqes dhe të sigurisë.

Gjinia i referohet roleve dhe marrëdhënieve, tipareve të personalitetit, qëndrimeve, sjelljeve dhe vlerave që shoqëria ua mvesh burrave dhe grave. Gjinia pra ka të bëjë me dallimet e nxjerra në mes të burrave dhe grave, ndërsa "seksi" i referohet dallimeve biologjike midis meshkujve dhe femrave. Rolet gjinore ndryshojnë gjërësisht brenda dhe ndërmjet kulturave, dhe mund të ndryshojnë me kalimin e kohës. Gjinia nuk i referohet thjeshtë vetëm grave ose burrave por edhe marrëdhënieve në mes tyre.

Integrimi i gjinisë në sektorin e mbrojtjes përfshin sjelljen e përvojës, njohurive dhe interesat e grave dhe burrave në procesin e krijimit të politikave dhe strukturave të mbrojtjes kombëtare, zbatimin e këtyre politikave (duke i përfshirë përmes operacioneve kombëtare dhe ndërkombëtare) dhe vlerësimin e rezultateve. Integrimi i gjinisë në procesin e reformës së mbrojtjes është një mjet për:

Përgjegjja nevojave të ndryshme të sigurisë brenda shoqërisë.

- Reforma e mbrojtjes duhet t'ju përgjigjet në mënyrë efektive nevojave të të gjithëve në shoqëri. Nevojat përkatëse të sigurimit të njerëzve ndryshojnë varësisht prej faktorëve si gjinia, nacionaliteti, moshë, aftësitë fizike, orientimi seksual, gjendja ekonomike, shtetësia dhe religjioni.
- Dhuna e bazuar në gjini (DBG) mbetet një kërcënim i rëndësishëm për sigurinë njerëzore gjithkund në botë. Burrat poashtu janë viktimë të DBG, në forma të tilla si masakra të orientuara kundër një gjinie, përdhunim dhe dhunë e lidhur me grupe kriminale. Garantimi i mbrojtjes së grave, burrave, vajzave dhe djemve si gjatë ashtu edhe pas konfliktit duhet të jetë një prioritet për çdo program të reformës për mbrojtje.

Përgjegjja nevojave në ndryshim të sektorit të mbrojtjes

- Natyra e luftës ka pësuar ndryshime shumë të mëdha. Forcat e Mbrojtjes janë, në shumë kontekste, të përfshira në misione komplekse të ruajtjes së paqes dhe rindërtimit të cilat kërkojnë aftësi të tilla si komunikimi, lehtësimi dhe bashkëpunimi me civilë. Shumëllojshmeria në fuqi, përbërje dhe gjini, i mundëson sektorit të mbrojtjes përfshirje në operacione dhe më mirë ti përmbush detyrat e reja që kërkojnë nga ai (shih Shembulli1).

Fillimisht në vitin 2008 ky dokument u botua me titull «Toolkit on Gender and Security Sector Reform» nga ana e Zyrës për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut të OSBE-së (ODIHR), Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura (DCAF) dhe Institutit Ndërkombëtar për Hulumtime dhe Trajnim për Avancimin e Femrave (UN-INSTRAW).

Shembulli 1 Paqëruajtësit femra mund të rrisin efektivitetin e misionit sepse:

- Personeli ushtarak femëror është i nevojshëm për të kryer kërkime të trupit tek gratë në postbllloqe, aeroporte, etj
- Burrat dhe gratë vendorë i shohin paqëruajtësit femra si më të afërt se paqëruajtësit meshkuj.
- Paqëruajtësit femra mund më lehtë të mbledhin informacione nga gratë lokale, duke siguruar shërbim të fshehtë me vlerë.
- Si burrat ashtu dhe gratë që janë viktime të abuzimit seksual ka me shumë gjasa t'ia bëjnë të ditur këte paqëruajtësit femër.
- Paqëruajtësit femra paraqesin shembuj pozitiv për gratë që të bashkangjiten në ushtri dhe në forcat mbrojtëse.

- Pjesëtarët e forcave të armatosura mund të jenë autorët e DBG kundër civilëve, si dhe anëtarë të tjerë të forcave të armatosura. Një qasje e të drejtave të njeriut promovimi i të cilit e ka parasysh gjininë, për shembull përmes trajnimit të ndjeshmërisë gjinore dhe zbatimit të kodeve të sjelljes, mund të forcojë parandalimin, përgjegjësinë e plotë dhe llogaridhënese.

Të krijohen forca përfaqësuese mbrojtëse dhe organizata të sigurisë

- Gratë janë të nën-përfaqësuar në ushtri, në Ministri të mbrojtjes dhe në organet mbikëqyrese mbrojtëse. Madje edhe pa pengesat formale, shpesh egzistojnë bariera në përparimin e grave në karrierë.
- Integrimi i plotë i grave në forcat e armatosura i maksimizon aftësitë ushtarake për të përmbushur rolin e vet në mbrojtjen e shoqërive demokratike, duke përfshirë mbrojtjen e vlerave kryesore të tilla si shtetësinë dhe barazinë.

Të perforcohen mbikëqyrja demokratike, civile e forcave mbrojtëse

- Një aspekt kyç i reformës së mbrojtjes është rritja e mbikëqyrjes civile. Përfshirja e grave dhe ekspertëve gjinor në organet mbikëqyrese mbrojtëse mund të ndihmojë për të siguruar që politikën e mbrojtjes dhe programet t'u përgjigjen nevojave të veçanta të burrave dhe grave, djemve dhe vajzave. Organizatat –shoqatat civile të grave mund të sjellin një kuptim tërësor të sigurimit për proceset civile mbikëqyrëse.

Pajtueshmëria me detyrimet sipas ligjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare

Marrja e iniciativës për të integruar çështjet gjinore në reformën e mbrojtjes është jo vetëm një çështje e efektivitetit operacional, por është gjithashtu e nevojshme që të përputhet me ligjet ndërkombëtare dhe rajonale, si dhe instrumentet dhe normat në lidhje me sigurinë dhe gjininë.

Instrumentet kryesore përfshijnë:

- *Deklarata dhe Platforma e Pekinit për Veprim (viti 1995)*
- *Rezoluta 1325e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë (viti 2000)*

Për më shumë informacion, shih Shtojcën "Për Ligjet dhe Instrumentet ndërkombëtare dhe rajonale".

Si mundet gjinia të integrohet në reformën e mbrojtjes?

Çështjet gjinore duhet të trajtohen nëpërmjet niveleve politike, institucionale, ekonomike dhe shoqërore të reformës së mbrojtjes.

Integrimi i gjinisë në nivelin politik të reformës së mbrojtjes.

- Të sigurohet që gratë dhe burrat me ekspertizë gjinore dhe përfaqësues të ministrive të Qeverisë përgjegjëse për çështjet e të drejtave të grave, gjinise dhe rinisë të jenë pjesë e organeve të shqyrtimit të mbrojtjes.
- Ndërtimi i kapaciteteve gjinore të organeve mbrojtëse shqyrtuese nëpërmjet trajnimit, informime mbi gjininë dhe çështjet e sigurise, programet e këshillimit, etj.
- Ndërtimi i kapaciteteve të organizatave të shoqërisë civile (OSHC), duke përfshirë organizatat e grave, në çështjet e politikës së mbrojtjes dhe mbikeqyrjen e sektorit të sigurisë.
- Nxitet debat në një vizion kombëtar të mbrojtjes dhe të sigurisë nëpërmjet:
 - Konsultimeve me shoqërinë civile, duke përfshirë organizatat urbane dhe rurale të grave
 - Seancave parlamentare dhe debateve të hapura
 - Angazhimit me mediat

Rast Studimi 1 Rritja e rekrutimit, mbajtjes dhe vendosjes (shpërndarjes) së grave në forcat e armatosura hungareze¹

Hungaria ka rritur me sukses pjesëmarrjen e femrave në forcat e saj të armatosura nga 4,3% në vitin 2005 në 17,56% në vitin 2006. Që kur pozicionet ushtarake janë hapur për gratë në vitin 1996, gratë janë në situatë të zënë çdo pozitë brenda forcave të armatosura hungareze. Strategjia e Hungarisë për të rritur punësimin, ruajtjen dhe vendosjen e grave përfshin:

- Ligjin e shërbimit ushtarak që mbështet të drejtat e barabarta të burrave dhe grave dhe garanton avancimin, nxitjen jo-diskriminuese në bazë të aftësisë profesionale, përvojës, performancës dhe kohës së shërbimit.
- Nje ekip me mundësi të barabarta dhe Plan me mundësi të barabarta brenda resurseve njerëzore.
- Një Komision për femrat e forcave mbrojtëse hungareze, themeluar në vitin 2003 për të siguruar mundësi të barabarta për burrat dhe gratë. Komiteti bën kërkime dhe mban takime me femrat në shërbim për të mbledhur përvojat, nga të cilat ata përgatisin analiza për statusin e barazisë gjinore, duke përfshirë edhe problemet dhe rekomandimet për ndryshime.
- Përmbledhje e pikave kryesore të intereseve të femrave me qëllim të standardizimit.
- Hapat për të përmirësuar kushtet e pushimit dhe higjienës në njësite.

Gana rregullisht kontribuon me trupa në misionet e OKB-së dhe ka integruar rregulla mbi standardet e sjelljes sipas OKB-se për forcat e armatosura në operacionet e paqes në kodin e vet kombëtar të sjelljes:

Shfrytëzimi Seksual dhe Abuzimi – kjo që vijon duhet të shmanget:

- Çfarëdo shkëmbim i parave, punës, mallrave ose shërbimeve për seks
- Çdo lloj aktiviteti seksual me fëmijë (persona nën moshën 18 vjeç)
- Te gjitha format tjera të sjelljes poshtëruese, degraduese ose shfrytëzuese
- Çfarëdo favor seksual në këmbim për asistencë;
- KÇfarëdo qoftë keqpërdorimi seksual që dëmton imazhin, kredibilitetin, paanësinë apo integritetin e forcave

Marrëdhënie Mashkull/Femër – Të mbështetet bashkëveprimi i shëndoshë dhe profesional mes meshkujve dhe femrave. Të mos inkurajohen marrëdhënie amoroale midis trupave.

Rregullat për Kodin e Sjelljes – Mos merr pjesë në akte amoroale të abuzimit ose shfrytëzimit seksual, fizik ose psikologjik. Respekto dhe mbështet të gjitha të drejtat e njeriut.

Integrimi i gjinisë në nivel institucional të reformës së mbrojtjes

- Në mënyrë aktive të rekrutohen gratë në strukturat e mbrojtjes dhe të bëhet e mundur që gratë të jenë të përfaqësuara në organet mbrojtëse vendim-marrëse. Rishikimi dhe ndryshimi i politikave të cilat kufizojnë pjesëmarrjen e grave dhe burrave, duke përfshirë kufizimin e grave në rolet luftarake ose në arritje të gradave më të larta (shih Studimi i rastit 1).
- Zbatimi i politikave familjare– p.sh. Pushim i lindjes si për nënat ashtu dhe për baballarët dhe mundësia për shfrytëzim të foshnjoreve dhe objekteve tjera me qëndrim ditor.
- Sigurimi që arsimimi dhe trajnimi ushtarak i adresohet ndjeshmërisë kulturore, përgjegjësisë qytetare, të drejtave të njeriut dhe përgjegjshmërisë-gjinore.
- Zhvillimi, zbatimi dhe monitorimi i kodeve të sjelljes për personelin e forcave të mbrojtjes që ndalojnë diskriminimin seksual, ngacmimin, shfrytëzimin dhe abuzimin (shih Studimi i rastit 2).

Integrimi i gjinise në nivelin ekonomik të reformës së mbrojtjes

- Të zhvillohen analiza gjinore të buxheteve të mbrojtjes për përmirësimin e transparencës, përgjegjshmërisë dhe menaxhimit financiar publik të sektorit të mbrojtjes (shih kutinë 2).
- Ndërtimi i kapacitetit të parlamentarëve dhe shoqërisë civile për të kryer analiza gjinore të buxhetit mbrojtjes.

Shembulli 2: Pyetje për të pyetur si pjese e analizës gjinore të buxhetit të mbrojtjes:

- A mundësojnë alokimet e përgjithshme siguri të barabartë për gratë, burrat, djemtë dhe vajzat?
- A përcakton buxheti fonde për gratë, burrat, vajzat apo djemtë (p.sh. fonde për të rekrutuar më shumë gra, për pushim të lindjes si për nënat ashtu edhe për baballarët, për shërbime shëndetësore për gratë dhe burrat)
- A përcakton buxheti aktivitete të lidhura me gjininë, inpute dhe kosto? (p.sh. të vetëdijes gjinore dhe trajnim për senzibilizim)

Integrimi i gjinise në nivelin shoqëror të reformës së mbrojtjes

- Portretizimi i grave brenda forcave të mbrojtjes në media për të nxjerrë në pah vlerën e shtuar që gratë ia sjellin mbrojtjes, si dhe për të ndryshuar pikëpamjet e shoqërisë për institucionet e mbrojtjes.
- Përkrahje të OSHC-ve, duke përfshirë organizatat e grave, që punojnë për paqe dhe çështje të sigurisë, në mënyrë që të fitohet pasqyrë (mendjehollësi), inteligjencë dhe të krijohet rrugë për bashkëpunim.

Gjithashtu në dispozicion në Tool 3 ...

- Këshilla se si mund të integrohet gjinia në procesin e shqyrtimit të mbrojtjes
- Mënyrat në të cilën parlamentarët mund të monitorojnë reformën e mbrojtjes
- Këshilla për rritjen e rekrutimit të femrave dhe të mbajtjes së tyre
- Shembuj se si çështjet gjinore janë drejtuar në reformën e mbrojtjes nga Republika Demokratike e Kongos, Estonia, Fixhi, Amerika Latine, Afrika e Jugut dhe Suedia

Sfidat dhe mundësitë e pas-konfliktit

Reforma e mbrojtjes është një aspekt i rëndësishëm i stabilizimit pas konfliktit. Çarmatimi, demobilizimi dhe riintegrimi (CCR) i ish-luftëtarëve është prioritet i cili në shumë raste është urgjent. Duke marrë parasysh që gratë janë si pjesëmarrëse ashtu edhe viktime të çdo konflikti, është e rëndësishme që nevojat dhe rolet e tyre të veçanta të jenë të drejtuara dhe pjesëmarrja e tyre e plotë të sigurohet nga fillimi i procesit të paqes dhe gjatë gjithë CCR dhe RSS.

Mundësi për integrimin e çështjeve gjinore

- Konsultim me bazë të gjerë, duke përfshirë organizatat e grave, për mbrojtjen dhe ndihmën e RSS për krijimin e konsensusit kombëtar mbi prioritetet e reformës.
- “Avokat-gjinor” meshkuj brenda ushtrisë dhe në poste të tjera me ndikim mund të jenë partnerë të fuqishëm për ndryshim.
- Miratimi i proceseve për ushtri të reja kombëtare perfiton nga konsultimet me grupet e grave dhe gratë ish-luftëtare, të cilët shpesh mund të japin informacione për autorët e shkeljeve të të drejtave të njeriut.

Në proceset CCR:

- Ekspertët gjinorë duhet të përfshihen në planifikimin, implementimin dhe vlerësimin.
- I gjithë personeli i CCR duhet të trajnohet në çështjet gjinore në mënyrë që ata të jenë në gjendje të planifikojnë, zbatojnë dhe vlerësojnë programet në një mënyrë të përgjegjshme-gjinore.
- Të dhënat e ndara seksuale duhet të mblidhen dhe të përdoren për të krijuar një tablo të qartë të të gjithë ish-luftëtarëve, të varurve dhe të tjerëve që lidhen me grupet e armatosura.
- Organizatat e grave duhet të marrin informacione për aspektet teknike dhe procedurale të CCR, që në atë mënyrë të mund të ndihmojnë që të sigurohet se gratë marrin pjesë në vendim-marrje dhe kuptojnë të drejtat e tyre.
- Mund të merren iniciativa për rekrutimin e ish-luftëtarëve femra në forcat e mbrojtjes.



Pyetje për reformën e mbrojtjes:

Gjinia mund të integrohet në reformën e mbrojtjes në mënyrë që të rritet efektiviteti i saj. Pyetjet kyçe për të pyetur si pjesë e proceseve të vlerësimit, monitorimit dhe vlerësimit janë:

- A ka pasur konsultim që të sigurohet se agjenda e reformës së mbrojtjes pasqyron intereset e grave dhe burrave të marginalizuar? A ka qenë OSHC-ja e përfshirë në proceset e shqyrtimit të mbrojtjes?
- A ka iniciativa për ndërtimin e kapaciteteve gjinore të organeve shqyrtuese mbrojtëse, parlamentarëve dhe organizatave të shoqërisë civile të angazhuar në mbikëqyrjen e mbrojtjes, të tilla si trajnimi gjinor dhe informime mbi gjininë dhe çështjet e sigurisë?
- A janë përcaktuar synimet dhe a janë vendosur mekanizmat në vend për të rritur punësimin, ruajtjen dhe avancimin e femrës në strukturat e mbrojtjes duke përfshirë edhe forcat e armatosura dhe Ministrinë e mbrojtjes?
- A ka masa konkrete, duke i përfshirë edhe kodet e sjelljes, monitorimin dhe mekanizmat e raportimit, për të parandaluar, përgjigjur dhe sanksionuar ngacmimin seksual dhe thyerjen e të drejtave të njeriut nga ana e personelit të mbrojtjes?
- A janë integruar çështjet gjinore në trajnimet standarde për të gjitha nivelet e personelit të mbrojtjes? A është trajnimi për vetëdijen gjinore dhe shfrytëzimin dhe abuzimin seksual i detyrueshëm për të gjithë personelin? A janë burrat të përfshirë në dhënien e trajnimit? Sa është trajnimi i përgatitur mirë?
- A është mbrojtja e grave, burrave, djemve dhe vajzave kundër të gjitha formave të DBG si gjatë ashtu edhe pas konfliktit një prioritet në agjendën e reformës së mbrojtjes?
- A është ndërmarrë analizë gjinore e buxhetit të mbrojtjes?

Më shumë informata:

Burime:

Anderlini, S.N. with Conaway, C.P. – *Negotiating the Transition to Democracy and Transforming the Security Sector: The Vital Contributions of South African Women*, 2004.

Committee on Women in the NATO Forces – *CWINF Guidance for NATO Gender Mainstreaming*, 2007.

DPKO – *Gender Resource Package*, 2004.

UN-INSTRAW – *Securing Equality, Engendering Peace: A Guide to Policy and Planning on Women, Peace and Security (UN SCR 1325)*, 2006.

UNIFEM – *Getting it Right, Doing it Right: Gender and Disarmament, Demobilisation and Reintegration*, 2004.

Organizata:

ACCORD – www.accord.org.za

DCAF – www.dcaf.ch

Institute for Security Studies – www.issafrica.org/

Siyanda: Mainstreaming Gender Equality – www.siyanda.org

UN-INSTRAW – www.un-instraw.org

Gjinia dhe RSS Toolkit

1. Reforma e Sektorit të Sigurisë dhe Gjinia
2. Reforma e Policisë dhe Gjinia
3. Reforma e Mbrojtjes dhe Çështjet Gjinore
4. Reforma e Drejtësisë dhe Çështjet Gjinore
5. Reforma Penale dhe Gjinia
6. Gjinia dhe Menaxhimi i Kufijve
7. Mbikëqyrja parlamentare në fushën e sigurisë dhe Gjinia
8. Berja e politikës për siguri kombëtare dhe Gjinia
9. Mbikëqyrja e Shoqërisë civile mbi Sektorin e Sigurisë dhe Gjinia
10. Kompanitë private ushtarake dhe të sigurisë dhe Gjinia
11. RSS Vlerësimi, monitorimi dhe vlerësimi dhe Çështjet Gjinore
12. Trajnimi gjinor për personelin e Sektorit të Sigurisë Shtojca për Ligjet dhe Instrumentet Ndërkombëtare dhe Rajonale

Secili nga këto Mjete dhe Shënime praktike janë në dispozicion nga: www.dcaf.ch, www.un-instraw.org dhe www.osce.org/odihr

Ky Shënim praktik është përgatitur nga Mugiho Takeshita nga DCAF-it, bazuar mbi Mjetin 3 nga autorët Cheryl Hendricks dhe Lauren Hutton të Institutit për Studime të Sigurisë.

¹ Committee on Women in the NATO Forces and the Women's Research & Education Institute, 'Percentages of Female Soldiers in NATO Countries' Armed Forces'; Committee on Women in the NATO Forces, 'Percentages of Military Service Women in 2006', and 'Hungarian National Report for 2006'.

² Extract from presentation by Klutsey, E.A. (Col.) on the Code of Conduct of Ghana, presented at the Preparatory Meeting on the Draft West African Code of Conduct for the Armed and Security Forces, Oct. 2005, pp. 24-26, http://www.dcaf.ch/awg/ev_accra_051024_presentation_Klutsey.pdf